



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2025:011412

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06777313

**PS.nr.4/2025**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË**, Kryetari i Trupit Gjykes-Gjyqtari Valon Kurtaj me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Fatlum Gashi e Bashkëpunëtores Profesionale Ardita Azemi në çështjen penale të të akuzuarit M. D. nga fshati ... i Komunës së O., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 nenin 31 të KPRK dhe veprën penale pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi nga neni 404 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, sipas Aktakuzës dhe Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë nën numrin PPS.nr.44/2023 të datës 22.01.2025 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokuror Bekim Kodraliu, të akuzuarit M. D. e mbrojtësit të tij, Avokat Bogdan Lazic, me datë 27.01.2025, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**M. D.**, nga i ati D., e ëma R. e vajzërisë R., i lindur më ... në M., posedon dokument identifikimi me numër personal ..., me banim në fshatin ... në rrugën “...” pa numër, Komuna e O., i pamartuar, ka të përfunduar shkollën e mesme, me profesion kamarier, i gjendja së dobët ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës dhe i Republikës së Serbisë, gjendet në masën e paraburgimit nga data 15.11.2024.

## ËSHTË FAJTOR

### I.

Me datë 29.05.2023, gjatë periudhës kohore nga ora 06:00 e deri në orët e mbrëmjes në perimetrin në të cilin gjendet objekti i Komunës së Z., i pandehuri M. D. në koordinim me shumë të pandehur tjerë të paidentifikuar, merr pjesë aktivisht në grupin e personave në kryerjen e veprave penale serioze, ku përmes përdorimit të dhunës i kanë sulmuar e seriozisht i kanë kanosur ushtarët e misionit paqeruajtës të “KFOR”, duke përdorë mjete të forta, shufra të ndryshme, molotov, mjete shpërthyesë të improvizuara e armë të zjarrit, nga të cilat janë lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të “KFOR”, ndërsa 3 (tre) nga ta janë lënduar nga predhat e armëve të zjarrit dhe disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës të cilët kanë qenë në detyrë zyrtare për të garantuar rendin e qetësinë publike për të gjithë qytetarët në atë pjesë, nga të cilat veprime kanë rrezikuar seriozisht jetën dhe trupin e këtyre personave zyrtarë të cilëve u kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore.

**Me këto veprime i pandehuri në bashkëkryerje e ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 e nenin 31 të KPRK.**

### II.

Me datë e kohë të njëjtë si në pikën I. të këtij aktgjykimi, i pandehuri M. D. në koordinim me shumë të pandehur tjerë të paidentifikuar, ka marrë pjesë aktiv në grupin, përkatësisht turmën e personave me qëllim të kryerjes së veprave penale serioze, ku përmes përdorimit të dhunës kanë tentuar që të pengojnë vendosjen e Rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës në Komunitet Veriore të vendit, ashtu që përkundër urdhrave të ushtarëve të misionit paqeruajtës të “KFOR” për shpërndarje të qetë të turmës e refuzim të hyrjes në objektin e komunës, i pandehuri M. D. së bashku me të pandehurit e tjerë kishin filluar që të ushtrojnë dhunë të pakontrolluar me mjete të forta, molotov, mjete shpërthyesë të improvizuara, armë zjarri nga të cilat seriozisht janë lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të “KFOR”, e pjesëtarë të Policisë së Kosovës, ku 3 (tre) janë lënduar nga predhat e armëve të zjarrit, duke shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme në automjetet e “KFOR”, Policisë së Kosovës, veturat e gazetarëve të cilët i kanë mbuluar ngjarjet e asaj dite, e që përfshijnë djegien e plotë të disa automjeteve ose dëmtimin fizik në masë të madhe, çka me këtë kanë shkaktuar rrezik në shkallë të gjerë për jetën, trupin e shumë njerëzve dhe pasurinë.

**Me këto veprime i pandehuri në bashkëkryerje e ka kryer veprën penale pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm nga neni 404 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 20, 21, 22, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69,79, e nenit 402 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe nenit 404 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIMIN ME BURGIM DHE ME GJOBË

Duke ia vërtetuar-shqiptuar për veprën penale të përcaktuar sikurse nën dispozitivin **I.** të Aktit akuzues dhe Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë, dënimin me burgim efektiv në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite** në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **15.11.2024** e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë me plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Për veprën penale sikurse nën dispozitivin **II.** të Aktit akuzues dhe Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj** e të cilin dënim, gjykata të njëjtit do t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë në lartësi prej **9,000.00 (nëntë mijë) Euro** të cilin dënim me gjobë i akuzuari duhet ta paguaj në afat kohor prej 3 (tre) muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë të akuzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur 20 (njëzet) Euro për një ditë burgimi.

**URDHËROHET** kthimi i sendit të sekuestruar përkohësisht, respektivisht telefoni i tipit "Samsung A52" pronë e të pandehurit M. D.;

Të akuzuarit masa e paraburgimit do t'i vazhdohet deri në ekzekutim të këtij aktgjykimi me vendim të posaçëm, mirëpo duke mos kaluar kohën e dënimit të shqiptuar.

Obligohet i akuzuari të paguaj shumën prej **100 (njëqind) Euro** në emër të shpenzimeve procedurale dhe shumën prej **100 (njëqind) Euro** në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

### A r s y e t i m

Me datë 22.01.2025, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur Aktin akuzues nën numrin PPS.nr.44/2023, kundër të akuzuarit M. D., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 e nenin 31 të KPRK, si dhe veprën penale pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi nga neni 404 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me Aktakuzën PPS.nr.44/2023 ka parashtruar dhe Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë nën numrin PPS.nr.44/2023 e hartuar në mes të Prokurorisë Speciale dhe të akuzuarit M. D.

Në Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë, palët kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku ndër të tjera është negociuar e propozuar edhe dënimi. Dënimi i propozuar, për veprën penale të përcaktuar sikurse nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë dënimin me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse për veprën penale sikurse nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e i cili dënim të njëjtit t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 9,000.00 (nëntë mijë) Euro.

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Bekim Kodraliu, sa i përket Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë me të gjitha kushtet e përcaktuara, ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit në harmoni me nenin 230 paragrafi 1 të KPRK, i ka propozuar gjykatës që ndaj të pandehurit M. D., për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar e kryer në bashkëkryerje nga neni 402 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ku në kuadër të këtij dënimi t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, ndërsa për veprën penale pjesëmarrje në turmë huliganizëm nga neni 404 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, t'i shqiptohet dënim me burg prej 6 muaj me mundësinë e zëvendësimit me gjobë prej 9,000.00 Euro. Po ashtu në harmoni me Marrëveshjen e arritur ka propozuar që masa e paraburgimit të mos i ndërpritet deri në përfundimin e mbajtjes së dënimit dhe pagesës së gjobës së shqiptuar nga ana e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. D., Avokat Bogdan Lazic dhe i akuzuari, kanë theksuar se qëndrojnë pranë Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë dhe se pajtohen me të gjitha kushtet e përcaktuara në Marrëveshje, duke marr parasysh faktin e Marrëveshjes për Pranimin të Fajësisë, ashtu siç kanë thënë në kuptim të dënimit nuk është e përcaktuar saktësisht, por që të dy pikat parashikohet dënim, do të thotë edhe me burgim por edhe me gjobë, si dhe ka kërkuar nga gjykata afat më të gjatë sa i përket pagesës së dënimit me gjobë.

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar nga akti i pranimit të Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë nga akuzuari, respektivisht nga provat-shkresat e lëndës e kushtet e pranimit të Marrëveshjes nga i akuzuari, ku i akuzuari ka pranuar fajësinë, respektivisht Marrëveshjen për veprat penale për të cilat akuzohet.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e në harmoni me nenin 251 të KPPRK, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, e marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit të lartë-theksuar e cila do të vë në mëdyshje pranimin e fajësisë-do ta bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë, respektivisht Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideron se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 248 të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës apo pushimin e procedurës penale.

Gjatë seancës për shqyrtimin e Marrëveshjes së Pranimit të Fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën-pasojat e Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë, për veprat penale e cilat i vihen në akuzë. Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë, respektivisht pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzime, pa presione, askush nuk i ka bërë ndonjë premtim të kundërligjshëm i cili do ta shtyjë në pranimin e Marrëveshjes, e ku pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin tij ka pranuar Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë.

Gjykata gjithashtu nga i akuzuari ka vërtetuar se Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë dhe veprën penale e cila i vihet në barrë e ka pranuar pa asnjë presion por me vullnet të plotë dhe se heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt.

Ndërsa sa i përket dënimit dhe vendimit mbi dënimin, si organi i akuzës e po ashtu dhe i akuzuari e mbrojtësi i tij, janë pajtuar me dënimin e negociuar dhe të propozuar në Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 69 të KPRK, erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të tij-akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen i akuzuari të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i akuzuari (respektivisht aktin e lidhjes së Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë), ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë-Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë i njëjti e ka shprehur që në fazat e hershme hetimore me lidhjen Marrëveshjes, gjendjen e tij ekonomike, momentalisht është i pa-punësuar, ka shprehur sjelljen korrekte ndaj gjykatës dhe institucioneve të ndjekjes penale që në fazën e hershme të hetimit dhe në bazë të evidencës penale për të njëjtin është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë-theksuara gjykata ka aprovuar Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë në tërësi me të gjitha elementet e saja, respektivisht ka aprovuar dënimin e propozuar nga palët-dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite për pikën si nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për veprën penale sikurse nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e të cilin dënim të njëjtit ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësi prej 9,000.00 (nëntë mijë) Euro. Gjykata, gjithashtu ka gjetur se dënimet e shqiptuar i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penale të tij dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen i akuzuari të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Gjykata në harmoni me nenin 113 të KPPRK, ka urdhëruar kthimin e telefonit të sekuestruar përkohësisht të tipit “Samsung A52”, pasi që të njëjtit i është bërë ekzaminimi, i pandehuri nuk i konteston të gjeturat në këtë telefon dhe prokuroria ka bërë kërkesë për kthimin e tij, andaj ka vlerësuar se nuk ka bazë të mëtejme për konfiskimin e të njëjtit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në harmoni me nenin 449, 450 e 452 të KPPRK.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**PS.nr.4/2025 datë 27.01.2025**

**Bashkëpunëtorë Profesionale,**  
**Ardita Azemi**

**Kryetari i Trupit Gjykes,**  
**Valon Kurtaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** ky Aktgjykim është i formës së prerë (i plotë-fuqishëm) që në momentin e shpalljes së tij, për faktin se palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.

\*\*\*